



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ datë 26 / 03 / 2025

**“PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË TË ARDHURAVE TË
PROGRAMIT BUXHETOR AFAT – MESËM “ 2026 -2028”**

Këshilli i Qarkut Vlorë, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, në funksion të përgatitjes së tavanëve përfundimtare për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028, bazuar në: Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 41, pika 1 dhe neni 83, pika ç; Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 52, pika 2; Ligjin nr. 57/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 28.02.2025, “Për përgatitjen e programit buxhetor vendor afatmesëm 2026–2028”;

V E N D O S I:

1. Të miratojë **Tavanet Përgatitore** për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028, të cilat përfshijnë:
 - Planin e transfertës së pakushtëzuar;
 - Planin e transfertës së kushtëzuar;
 - Planin e të ardhurave të Këshillit të Qarkut Vlorë, sipas dokumentit bashkëngjitur “Tavanet përgatitore të të ardhurave”, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:
 - Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria Financës dhe Shërbimeve, Koordinimit të Projekteve, Politikave Sociale dhe Turizmit.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600

- o Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria Financës dhe Shërbimeve, Koordinimit të Projekteve, Politikave Sociale dhe Turizmit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli i Qarkut, në përputhje me nenin 78, pika 3, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Grupi I punës:

ZV/Kryetari i Këshillit të Qarkut

Harallamb Pandehi

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social

Anisa Hyseni

Specialist Finance për Zbatimin e Buxhetit

Mauricio Pashaj

Specialist për shërbimet, transportin dhe emergjencat civile

Muhedin Bego

Specialist për arsimin, kulturen, turizmin, çeshtjet sociale dhe zhvillimin e projekteve

Ilda Lamaj

Specialist për urbanistikën dhe zhvillimin e teritorit

Blerina Lula

Specialist jurist

Alma Myrtaj

KRYETARI

Ervis Moçka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

RELACION

Lidhur me projektvendimin “Për miratimin e tavaneve përgatitore të të ardhurave të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028”

1.Baza ligjore

Ky relacion bazohet në:

- Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 38, 41 dhe 83;
- Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 52;
- Ligjin nr. 57/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar”;
- Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018;
- Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor vendor afatmesëm 2026–2028”;

2.Të dhënat financiare dhe parashikimet për 2026–2028

Pas analizave të detajuara dhe diskutimeve të zhvilluara, janë parashikuar këto tavane përgatitore të të ardhurave të Këshillit të Qarkut për PBA 2026–2028:

Zëri	2026	2027	2028
Transferta e pakushtëzuar	68,942,875 lekë	70,642,417 lekë	72,377,632 lekë
Transferta e kushtëzuar – DAMT	10,300,000 lekë	10,400,000 lekë	10,500,000 lekë
Transferta e kushtëzuar – Qendra Sociale “Vatra”	18,500,000 lekë	18,900,000 lekë	20,500,000 lekë
Të ardhura të veta	16,600,000 lekë	16,700,000 lekë	16,800,000 lekë
Totali	114,342,875 lekë	116,642,417 lekë	120,177,632 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

Këto të ardhura do të shërbejnë si bazë për hartimin e planifikimit të shpenzimeve buxhetore dhe përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit të qarkut për periudhën në fjalë.

3. Parimet e planifikimit dhe supozimet

Planifikimi është kryer mbi bazën e analizës së performancës financiare të viteve të kaluara dhe të pritshmërive realiste për burimet financiare të disponueshme. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, të ardhurat e qarkut përbëhen nga:

- **Transferta e pakushtëzuar**, e përcaktuar nga Ministria e Financave në kuadrin makroekonomik dhe fiskal;
- **Transferta të kushtëzuara**, për funksione të deleguara si:
 - Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT);
 - Qendra Psiko-Sociale “Vatra”;
- **Të ardhurat e veta**, të mbledhura nga ofrimi i shërbimeve publike si DAMT, urbanistika dhe shërbime të tjera administrative;
- **Kuotat e anëtarësisë** nga bashkitë përbërëse të qarkut, të miratuara me vendim të këshillave bashkiakë;
- **Të ardhurat e trashëguara** të pashfrytëzuara nga vitet e mëparshme.

4. Prioritetet dhe sfidat

Për Këshillin e Qarkut Vlorë, mbetet prioritet **zhvillimi dhe zbatimi i politikave rajonale**, në bashkëpunim me bashkitë e qarkut, në fushat:

- Ekonomike dhe sociale;
- Turizmit dhe trashëgimisë kulturore;
- Mbrojtjes së mjedisit;
- Forcimit të kapaciteteve institucionale dhe qeverisjes vendore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

5. Konkluzion

Bazuar në të gjitha analizat dhe vlerësimet e sipërpërmendura, miratimi i këtij vendimi është i domosdoshëm për të siguruar një bazë realiste dhe të qëndrueshme për hartimin e programit buxhetor 2026–2028, në përputhje me objektivat strategjike të Këshillit të Qarkut Vlorë.

Grupi I punës:

ZV/Kryetari i Këshillit të Qarkut

Harallamb Pandehi

Drejtor Dretoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social

Anisa Hyseni

Specialist Finance për Zbatimin e Buxhetit

Mauricio Pashaj

Specialist për shërbimet, transportin dhe emergjencat civile

Muhedin Bego

Specialist për arsimin, kulturen, turizmin, çështjet sociale dhe zhvillimin e projekteve

Ilda Lamaj

Specialist për urbanistikën dhe zhvillimin e teritorit

Blerina Lula

Specialist jurist

Alma Myrtaj

KRYETARI

Ervys Moçka

Tavanet Përgatitore të PBA 2026-2028

Transferta e pakushtëzuar

Këshilli i Qarkut

në lekë

2026	2027	2028
68,942,875	70,642,417	72,377,632

Transferta e Kushtëzuar

Funksion i deleguar - DAMT

në lekë

2026	2027	2028
10,300,000	10,400,000	10,500,000

Transferta e Kushtëzuar

Shërbimet e Qëndrë Sociale Vatra

në lekë

2026	2027	2028
18,500,000	18,900,000	20,500,000

Të ardhura të planifikuara

Këshilli i Qarkut

në lekë

2026	2027	2028
16,600,000	16,700,000	16,800,000

TOTALI

në lekë

2024	2025	2026
114,342,875	116,642,417	120,177,632